

[Type here]

**KONFERENCA MBI ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN
- SHQIPËRIA –**

Bruksel, 11 tetor 2024
(originali në anglisht)
AD 18/24

LIMITE
CONF-ALB 3

DOKUMENTI I ANËTARËSIMIT

**Tema: QËNDRIMI I PËRBASHKËT I BASHKIMIT EVROPIAN
- Grupkapitulli 1: Themelorët**

[Type here]

QËNDRIMI I PËRBASHKËT I BASHKIMIT EVROPIAN

Ky qëndrim i Bashkimit Evropian bazohet në qëndrimin e tij të përgjithshëm për konferencën e anëtarësimit me Shqipërinë (AD 5/22 CONF-ALB 2), dhe është në harmoni me parimet negociuese të miratuara në të, veçanërisht me sa vijon:

- çfarëdolloj pikëpamjeje e shprehur qoftë nga Shqipëria, qoftë nga BE-ja mbi kapituj specifike të negociatave nuk do të cenon në asnjë mënyrë qëndrimin që mund të mbahet për kapitujt e tjerë;
- dakordësitë e arritura gjatë negociatave për kapituj specifike, qoftë edhe dakordësi të pjesshme, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare derisa të arrihet një dakordësi e përgjithshme për të gjithë kapitujt;

si dhe sa u përket kërkesave të përcaktuara në pikat 3, 5, 10, 14, 16, 31, 33, 36, 38, 39, 46, 47 dhe 48 të Kuadrit të Negocimit.

BE-ja inkurajon Shqipërinë të vazhdojë procesin e përafrimit me acquis-në e BE-së dhe zbatimin e tij efikas dhe të detyrueshëm, si dhe të hartojë në përgjithësi, që përpara anëtarësimit, politika dhe instrumente sa më afër atyre të BE-së.

BE-ja vëren se Shqipëria, në qëndrimin e saj AD 19/24 CONF-ALB 4 pranon acquis-në e BE-së në kuadrin e grupkapitullin 1, hyrë në fuqi që më 2 tetor 2024 dhe se do të jetë gati ta zbatojë atë brenda datës së anëtarësimit të saj në Bashkimin Evropian.

1. **Funksionimi i institucioneve demokratike**

BE-ja vëren se Shqipëria ka hedhur themelet e një **shteti demokratik** në rendin e saj kushtetues dhe po punon për konsolidimin e institucioneve të saj demokratike dhe se kuadri i saj ligjor dhe institucional lejon zhvillimin e proceseve zgjedhore demokratike. BE-ja e inkurajon Shqipërinë të trajtojë disa paqartësi ligjore dhe mospërputhje të vëna në pah nga OSBE/ODIHR-i, si dhe të zbatojë rekomandimet e tjera të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias. Legjislacioni mbi median në fushatat zgjedhore, veçanërisht sa i përket dezinformimit dhe platformave *online* duhet të forcohet më tej. Lidhur me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, BE-ja vlerëson pozitivisht garantimin e një transparence më të madhe përmes rishikimit të kuadrit legjislativ, por vë në dukje nevojën për konsolidimin e zbatimit të ndryshimeve të bëra.

BE-ja konstaton se roli i **Kuvendit** të Shqipërisë është konsoliduar me kalimin e kohës. BE-ja inkurajon ndërmarrjen e përpjekjeve të mëtejshme për më shumë transparencë dhe llogaridhënie, integritet dhe efikasitet, duke përfshirë edhe në ndërveprimet ndërmjet Parlamentit dhe OJQ-ve/OSHC-ve dhe në lidhje me publikimet e tij. BE-ja rikujton se një Parlament funksional që ushtron një rol efikas mbikëqyrës dhe legjislativ përbën një shtyllë qendrore të procesit të anëtarësimit. BE-ja rikujton se Parlamenti duhet të jetë në gjendje të përdorë të gjithë mekanizmat, duke përfshirë edhe komisionet hetimore, për të mbikëqyruar në mënyrë efikase punën e qeverisë. BE-ja nënvizon se një dialog politik konstruktiv dhe gjithëpërfshirës në parlament është thelbësor dhe në interes të qytetarëve shqiptarë. Më tej, BE-ja vëren se pavarësisht se aktiviteti parlamentar vazhdon të ndikohet negativisht nga polarizimi

[Type here]

politik, Parlamenti ka arritur të miratojë disa ndryshime legislative me shumicën e votave të disa partive parlamentare për forcimin e rolit të tij në procesin e integritetit në BE.

BE-ja nënvizon se Shqipëria e ka në përgjithësi një kuadër ligjor, rregullator dhe institucional për **Organizatat e Shoqërisë Civile** në fuqi, por nevojiten përmirësime për të mundësuar zbatimin e plotë të këtij kuadri ligjor, veçanërisht sa u takon procedurave të regjistrimit. BE-ja vëren se proceset e konsultimit duhet të përmirësohen për t'u bërë më gjithëpërfshirëse, për të rritur efektivitetin dhe cilësinë dhe se nevojiten përpjekje dhe burime të tjera për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm dhe të favorshëm për shoqërinë civile.

2. Reforma e administratës publike

BE-ja vëren se Shqipëria është deri diku e përgatitur sa i përket **kuadrit strategjik të reformës së administratës publike**. BE-ja nënvizon nevojën e hartimit dhe miratimit në kohë nga ana e Shqipërisë të strategjive të reja të Reformës së Administratës Publike (RAP) dhe Menaxhimit të Financave Publike (MFP) për të siguruar vazhdimësinë e reformave. Duhet të sigurohet konsistenca në tërësi mes Strategjisë së Reformës së Administratës Publike dhe dokumenteve të tjera strategjike dhe dokumenteve të planifikimit të politikave, si dhe qëndrueshmëria financiare e reformave që lidhen me Reformën e Administratës Publike. BE-ja nënvizon se sistemi i koordinimit të politikave mbetet kompleks dhe duhet të thjeshtohet dhe se koordinimi dhe drejtimi politik i zbatimit dhe monitorimit të reformave duhet të përmirësohet.

BE-ja nënvizon se Shqipëria është deri diku e përgatitur për **zhvillimin dhe koordinimin e politikave** të saj. Në fushën e zhvillimit të politikave, legjislacioni është pjesërisht i harmonizuar me standardet e BE-së. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të përmirësojë kuadrin e saj rregullator për përmirësimin e planifikimit afatmesëm të politikave, për një përdorim më të gjerë të vlerësimit të ndikimit të të gjitha akteve nënligjore në kuadrin rregullator, dhe për përforcimin e rolit mbikëqyrës të parlamentit mbi qeverinë.

BE-ja thekson se legjislacioni i Shqipërisë për **shërbimin civil** përputhet gjerësisht me parimet thelbësore të rekrutimit, promovimit dhe shkarkimit nga puna në mënyrë transparente dhe në bazë merite. Megjithatë, dispozitat për rekrutimin dhe promovimin në bazë merite duhet të zbatohen në mënyrë konsistente në të gjitha nivelet në praktikë. BE-ja vëren gjithashtu se Shqipëria duhet të reformojë sistemin e saj të pagave për ta bërë atë më transparent, më të drejtë dhe me kritere të qarta për shtesat dhe rritjet e pagave. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet gjithashtu të harmonizojë dhe të zbatojë një sistem klasifikimi të vendeve të punës në të gjitha institucionet.

BE-ja vëren se korniza aktuale ligjore për **organizimin e organeve qendrore administrative** nuk ofron tipologji dhe kritere të qarta për krijimin e organeve të varësisë dhe as nuk parashikon qartë linjat e llogaridhënies ndërmjet organeve mbikëqyrëse dhe atyre vartëse. BE-ja e inkurajon Shqipërinë ta trajtojë këtë çështje, si dhe të forcojë mbikëqyrjen e agjencive në varësi nga ministrinë përkatëse. BE-ja nënvizon më tej se Shqipëria duhet të përmirësojë transparencën e institucioneve publike, duke përfshirë forcimin e aksesit të qytetarëve në informacionin publik.

BE-ja rikujton se dixhitalizimi është rruga drejt një administrate publike më të mirë duke ofruar shërbime elektronike më efikente, më efikase dhe të një cilësie të lartë dhe me më pak kosto

[Type here]

administrative dhe më pak ngarkesë për qytetarët dhe bizneset. BE-ja vëren se Shqipëria ka ndërmarrë një proces ambicioz të **dixhitalizimit të shërbimeve publike** duke arritur aktualisht dixhitalizimin e 95% të të gjitha shërbimeve publike. BE-ja e inkurajon Shqipërinë të garantojë trajtim dhe akses të barabartë në shërbimet administrative për të gjithë qytetarët dhe bizneset. BE-ja e inkurajon më tej Shqipërinë të vazhdojë përpjekjet për thjeshtimin e proceseve dhe shërbimeve administrative dhe për të forcuar sigurinë kibernetike. BE-ja vëren planet e Shqipërisë për rishikimin e legjislacionit të saj mbi interoperabilitetin. Duke pasur parasysh këtë, BE-ja rikujton nevojën për forcimin edhe të interoperabilitetit ndërkufitar përmes një kuadri kombëtar interoperabiliteti që është plotësisht në përputhje me Kornizën Evropiane të Interoperabilitetit si bazë për shërbime publike dixhitale ndërvepruese dhe me në qendër njeriun. BE-ja inkurajon Shqipërinë të monitorojë zhvillimet në acquis-në dixhitale të BE-së, në veçanti legjislacionin e BE-së për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besimit (Rregullorja eIDAS), e cila aktualisht po rishikohet me qëllim krijimin e një portofoli kombëtar të identitetit dixhital.

BE-ja vëren se Shqipëria ka një kuadër të konsoliduar për **menaxhimin e financave publike**. BE-ja nënvizon rëndësinë që ka përmirësimi i mëtejshëm nga ana e Shqipërisë i kuadrit buxhetor afatmesëm dhe rritja e kapaciteteve institucionale për monitorimin e rreziqeve fiskale dhe përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike. BE-ja e inkurajon Shqipërinë të krijojë një Këshill Fiskal për të forcuar besueshmërinë e politikave fiskale në vend.

3. Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

BE-ja nënvizon se kuadri legjislativ dhe institucional i Shqipërisë ka një nivel të lartë përputhshmërie me acquis-në e BE-së dhe standardet evropiane përkatëse për **funksionimin e gjyqësorit**. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të avancuar më tej **reformën në drejtësi** të vitit 2016 duke vazhduar me forcimin e pavarësisë së magjistratëve dhe të sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale, konsolidimin e llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet, garantimin e aksesit dhe cilësisë së drejtësisë dhe garantimin e vendosjes efikente të drejtësisë në përputhje me acquis-në e BE-së dhe standardet evropiane.

BE-ja vlerëson përparimet e Shqipërisë sa i përket **pavarësisë dhe paanshmërisë** së sistemit gjyqësor dhe prokurorial. BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për të vazhduar me ngritjen e kapaciteteve, rritjen e pavarësisë dhe efikasitetit të organeve vetëqeverisëse të gjyqësorit dhe konsolidimin e progresit nëpërmjet emërimeve dhe zhvillimit në karrierë në bazë merite, duke rritur transparencën e ngritjeve në detyrë dhe duke zbatuar me përpikëri kontrolle të plota periodike të integritetit gjatë karrierës së magjistratëve. BE-ja vlerëson gjithashtu angazhimin e Shqipërisë për t'iu përmbajtur standardeve të larta të vendosura nga procesi i vetingut dhe për të garantuar zbatimin me efikasitet në praktikë të rregullit të ndarjes në mënyrë të rastësishme të çështjeve gjyqësore. BE-ja vlerëson më tej pozitivisht planet e Shqipërisë për të forcuar më tej qëndrueshmërinë e institucioneve të drejtësisë ndaj rasteve të ndërhyrjeve nga brenda dhe jashtë sistemit. BE-ja nënvizon nevojën që si ekzekutivi ashtu edhe legjislativi i Shqipërisë të respektojnë dhe zbatojnë plotësisht, me prioritet, vendimet detyruese të Gjykatës Kushtetuese. BE-ja nënvizon rëndësinë që ka garantimi nga Shqipëria i standardeve më të larta të integritetit, transparencës dhe meritës në emërimin e anëtarëve të organeve vetërregulluese dhe të organeve të tjera kyçe gjyqësore dhe prokuroriale.

[Type here]

BE-ja vëren se Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe institucional që siguron një rregullim të fortë të **llogaridhënies**. BE-ja vlerëson pozitivisht vazhdimësinë e mirë të zbatimit të procesit të vetingut nga Shqipëria dhe planin e saj për të përmbyllur në mënyrë të rregullt procesin e vetingut brenda afateve kushtetuese, nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. BE-ja nënvizon nevojën e Shqipërisë për të vazhduar fillimin e procedurave penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të vetingut dhe rëndësinë e zbatimit të standardeve të larta të vendosura nga procesi i vetingut. BE-ja vlerëson gjithashtu se Shqipëria planifikon të marrë masa që shërbimet e inspektimit dhe institucionet vetëqeverisëse, veçanërisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të mundësojnë në mënyrë konsistente një historik solid të llogaridhënies dhe integritetit në sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet. Shqipëria duhet të sigurojë nivelin më të lartë të integritetit dhe meritës në emërimet e anëtarëve jomagjistratë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

BE-ja vlerëson bazën e mirë që ka Shqipëria për **cilësinë dhe eficientë** e sistemit gjyqësor. BE-ja vlerëson pozitivisht planin e Shqipërisë për të siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të mundësuar funksionimin e plotë, efikas dhe të pavarur të gjyqësorit dhe për të garantuar të drejtën për akses në drejtësi. BE-ja thekson pozitivisht planin e Shqipërisë për të forcuar Shkollën e Magjistraturës, duke përfshirë përmirësimin e provimit të pranimit bazuar në transparencë dhe konkurrencë të ndershme, për të ofruar një arsim të nivelit të lartë për magjistratët aspirantë. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të përmirësuar mjetet e TI-së në dispozicion të gjykatave dhe e inkurajon që të ngrejë në kohë një sistem të integruar për menaxhimin e çështjeve dhe të plotësojë vazhdimisht me prioritet vendet e mbetura vakante në sistemin gjyqësor për një drejtësi eficiente.

BE-ja vlerëson se kuadri legjislativ dhe institucional i Shqipërisë për **antikorrupsionin** është pjesërisht në përputhje me acquis-në e BE-së. BE-ja vlerëson pozitivisht disa dënime të formës së prerë për akuza ndaj disa zyrtarëve të rangut të lartë për korrupsion. Megjithatë, BE-ja nënvizon se korrupsioni është i përhapur në shumicën e fushave të jetës publike dhe në biznes, duke përfshirë në të gjitha degët e qeverisjes dhe institucionet qendrore dhe vendore dhe mbetet një fushë që përbën shqetësim serioz. BE-ja vlerëson më tej se masat kundër korrupsionit kanë pasur një ndikim përgjithësisht të kufizuar deri më tani, veçanërisht në sektorët më të rrezikuar nga korrupsioni. BE-ja vë vlerëson planet e Shqipërisë për ta ndryshuar më tej kuadrin e saj ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit, për ta bërë atë më pak kompleks dhe më eficient në zbatim. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të bëjë përparim vendimtar drejt adresimit të pandëshkueshmërisë dhe natyrës së përgjithshme dhe të gjerë të korrupsionit, dhe vlerëson pozitivisht planet e Shqipërisë për të forcuar kapacitetet dhe koordinimin institucional për parandalimin e korrupsionit, konsolidimin e kapaciteteve operationale dhe njerëzore të Prokurorisë së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (SPAK) dhe gjykatave të posaçme dhe drejt krijimit të një historiku solid në goditjen sistematike të korrupsionit, veçanërisht në nivele të larta, duke përfshirë edhe konfiskimin në fund të aseteve. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të forcuar efikasitetin e kuadrit të parandalimit të korrupsionit, duke përfshirë adresimin sistematik dhe efikas të rekomandimeve të Grupit të Shteteve të Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO). BE-ja vlerëson rëndësinë e përputhshmërisë së ndryshimeve ligjore që Shqipëria synon të bëjë në të ardhmen në legjislacionin penal, duke përfshirë edhe amnistitë e mundshme, me acquis-në e BE-së dhe me

[Type here]

standardet evropiane dhe rëndësinë e përputhshmërisë së këtyre ndryshimeve me planin e Shqipërisë për reduktimin e vazhdueshëm të korrupsionit.

BE-ja vëren se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me acquis-në e BE-së dhe standardet evropiane për **të drejtat themelore** dhe nënvizon se zbatimi i tij duhet të forcohet për të garantuar gëzimin e të drejtave themelore në praktikë, duke përfshirë edhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të të drejtave themelore.

BE-ja vlerëson se duhen ende përpjekje për të garantuar **mbrojtjen e të dhënave personale** në Shqipëri. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të harmonizuar kuadrin e saj ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale me acquis-në e BE-së dhe për të rritur kapacitetin institucional të Komisionerit për Mbrojtjen e Informacionit dhe të Dhënave, si dhe të kontrollorëve publikë dhe privatë për të garantuar zbatimin efikas të kësaj të drejte, duke përfshirë edhe masat për ndërgjegjësimin e publikut. BE-ja nënvizon planin e Shqipërisë për të hetuar në mënyrë efikase shkeljet e të drejtave të mbrojtjes së të dhënave, duke përfshirë edhe ato në shkallë të gjerë.

BE-ja vlerëson se sa i përket **lirisë së shprehjes**, kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me acquis-në e BE-së dhe standardet përkatëse evropiane dhe se ka nevojë për përmirësime të konsiderueshme. BE-ja vlerëson pozitivisht planin e Shqipërisë për të mundësuar një reformë të thellë të kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe marrjen e masave të nevojshme zbatuese me qëllim: forcimin e transparencës së pronësisë së medias, pluralitetit të medias dhe pavarësisë editoriale, forcimit të transparencës së financimit të medias nga burimet private dhe shtetërore dhe forcimit të autonomisë së rregullatorit të medias dhe pavarësisë së transmetuesit shtetëror. BE-ja vëren se atmosfera e sulmeve verbale dhe fizike, fushatave shpifëse dhe padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) që kanë në shënjestër gazetarët nuk ka ndonjë përmirësim dhe mbetet për t'u adresuar. BE-ja nënvizon rëndësinë e shfuqizimit të plotë nga Shqipëria të dispozitave penale për fyerjen dhe shpifjen dhe harmonizimit të aspekteve civile të shpifjes me standardet evropiane. BE-ja nënvizon se do të duhet që kjo çështje të ndiqet me vëmendje në mënyrë që masat dhe garancitë mbrojtëse të ndërmarra të zbatohen në mënyrë efikase dhe të përkthehen në përmirësime të prekshme për sigurinë dhe mjedisin e punës së gazetarëve. Çdo ndryshim në kuadrin ligjor duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rekomandimet evropiane, duke përfshirë edhe opinionet e Komisionit të Venecias, dhe duhet t'u nënshtrohet konsultimeve gjithëpërfshirëse me organizatat e medias dhe shoqërisë civile.

Lidhur me **barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin** ku Shqipëria ka arritur harmonizim të pjesshëm me acquis-në e BE-së, BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për ta përafëruar plotësisht kuadrin e saj ligjor për mos diskriminimin me acquis-në e BE-së dhe për të siguruar zbatimin e tij efikas, duke përfshirë edhe zbatimin e tij nga Komisioneri për Mosdiskriminimin ndër të tjera, edhe sa i përket komunitetit LGBTIQ. BE-ja vlerëson gjithashtu planet e Shqipërisë për të siguruar harmonizim të plotë me acquis-në e BE-së për barazinë gjinore, duke përfshirë Konventën e Stambollit, në veçanti për të trajtuar në mënyrë efikase dhunën me bazë gjinore, për të rritur kapacitetet institucionale duke përfshirë edhe organet e barazisë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e strehëzave për viktimat e dhunës. BE-ja nënvizon nevojën për të siguruar zbatimin në kohë të masave, duke përfshirë përafrimin e dispozitave ligjore për mosdiskriminimin, luftën ndaj krimeve të urrejtjes, gjuhës së urrejtjes, dhunës me bazë gjinore,

[Type here]

dhe sigurimin e barazisë gjinore. BE-ja e inkurajon Shqipërinë që të caktojë burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve për dëmshpërblimin dhe ndihmën për viktimat. Shqipëria merr përsipër të forcojë më tej të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të mbështetur dhe rritur mbrojtjen e **të drejtave të fëmijës** duke zgjeruar disponueshmërinë e shërbimeve me bazë komunitetin me synim reduktimin e institucionalizimit të fëmijëve. BE-ja thekson rëndësinë që ka progresi vendimtar që duhet të arrijë Shqipëria në përmbylljen e tranzicionit drejt kujdesit me bazë në komunitet, duke përfshirë edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. BE-ja nënvizon nevojën për një zbatim në kohë të reformës për garantimin e respektimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës.

Lidhur me **të drejtën e pronës**, BE-ja vëren se Shqipëria ka miratuar akte nënligjore në zbatim të Ligjit për Kadastrën dhe Ligjin për finalizimin e proceseve të kalimtare të pronësisë, por zbatimi vazhdon të hasë sfida të konsiderueshme. Në veçanti, sipas Udhërrëfyesit për kapitujt e sundimit të ligjit, do të krijohet një sistem efikas dhe transparent i regjistrimit dhe menaxhimit të integruar të pronës, i cili do të ofrojë tituj të qartë dhe të sigurt pronësie në Shqipëri, për të garantuar të drejtën e pronës nëpërmjet një shërbimit plotësisht dixhital në praktikë deri në vitin 2030. Në këtë kuadër, Shqipëria i ka vënë vetes dy objektiva të ndërmjetme për vitin 2026 dhe 2028. Objektivi i parë ka të bëjë me dixhitalizimin e hartave kadastrale, ndërsa i dyti me përfundimin e regjistrimit fillestar. Në këtë drejtim, BE-ja thekson gjithashtu se Shqipëria duhet të sigurojë publikimin e hartave kadastrale në përputhje me procesin e dixhitalizimit, i cili deri tani mbetet i kufizuar. Ajo thekson rëndësinë që ka marrja e masave nga Shqipëria në mënyrë që sapo të publikohen hartat kadastrale individuale dhe palët e interesuara të dorëzojnë dokumentet e kërkuara për regjistrimin e pasurive të tyre, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, siç përcaktohet në kuadrin e saj ligjor në fuqi, të procedojë brenda afatit të caktuar 45-ditor me lëshimin e certifikatës përfundimtare të pronësisë ose ta informojë të interesuarin se prona në fjalë pretendohet edhe nga palë të treta (qofshin ato shtetërore apo private), në mënyrë që i interesuari të mund t'i drejtohet drejtësisë.

Përveç kësaj, BE-ja i bën thirrje Agjencisë Shtetërore të Kadastrës që të ndërmarrë masa të fuqishme kundër korrupsionit përmes një Plani të Integritetit Antikorrupsion (PIA), duke reflektuar reagimet e palëve të interesuara me synim përmirësimin e transparencës, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë në ofrimin e shërbimeve nga viti 2025 e tutje, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për kapitujt e Sundimit të Ligjit. Ajo gjithashtu nënvizon se marrja e sqarimeve periodike dhe të hollësishme në lidhje me zbatimin e AIP-së mbetet thelbësore. BE-ja thekson se edhe Agjencia e Trajtimit të Pronave duhet të funksionojë me transparencë të plotë. Ajo kërkon vendosjen e një afati kohor realist për ekzekutimin e kompensimeve të mundshme që duhet të mbyllet brenda 2026-ës, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit. Në këtë drejtim, BE-ja u bën thirrje autoriteteve shqiptare që të merren edhe me çështjen e dokumenteve të falsifikuara, siç përkrahjet në Konkluzionet e Këshillit për Zgjerimin të dhjetorit 2023. Për më tepër, BE-ja rithekson se rishikimi i ligjeve të investimeve në përputhje me praktikën më të mirë të BE-së mbetet një çështje shumë prioritare për t'u trajtuar deri në vitin 2026, siç parashikohet në Axyhendën e Reformës së Planit të Rritjes. Në veçanti, ajo u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masa që shpronësimet në emër të “interetit publik” të shoqërohen me kompensime të drejta për pronarët e ligjshëm. Ajo gjithashtu thekson se një proces i qartë i klasifikimit të pronave (tokë arë ose truall ndërtimi) do të ndihmonte në

AD 18/24

CONF-ALB 3/24

[Type here]

parandalimin e klasifikimeve të gabuara dhe çdo akti abuzimi. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të garantuar mbrojtje efektive gjyqësore dhe për të siguruar zbatimin konsistent të vendimeve gjyqësore, veçanërisht të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në këtë fushë.

BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave që u përkasin **pakicave**, në përputhje me detyrimet e saj ndërkombëtare dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare, duke siguruar ndër të tjera zbatimin efektiv të kuadrit të saj ligjor. Ajo vazhdon ta nxisë Shqipërinë të miratojë aktet e tjera nënligjore që priten të miratohen për zbatimin e këtij kuadri në lidhje me vetë-identifikimin dhe të drejtat e tjera të lidhura me të dhe me përdorimin e gjuhëve të pakicave kombëtare në kontaktet e tyre me organet administrative dhe autoritetet publike deri në fund të vitit 2024, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit. Ajo thekson se miratimi dhe zbatimi i shpejtë i këtyre akteve nënligjore në të gjithë territorin duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës, në përputhje me Konkluzionet e Këshillit për Zgjerimin të dhjetorit 2023. Në miratimin e akteve nënligjore të sipërpërmendura, BE-ja u bën thirrje autoriteteve shqiptare të garantojnë që e drejta për vetë-identifikimin e lirë të respektohet si në ligj ashtu edhe në praktikë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. BE-ja thekson gjithashtu nevojën për të rritur kapacitetin institucional të Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare dhe të autoriteteve vendore. Lidhur me pakicat rome dhe egjiptiane, BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për të përmbushur angazhimet e Deklaratës së Poznanit në fushën e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetësisë dhe për të forcuar Pikën Kombëtare të Kontaktit për Romët. BE-ja e inkurajon Shqipërinë të caktojë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme kombëtare për zbatimin e masave të politikave dhe të përforcojë koordinimin në këtë fushë. Ajo thekson më tej se Shqipëria ka dispozita që u mundësojnë personave që u përkasin pakicave të ruajnë dhe të zhvillojnë trashëgiminë e tyre kulturore dhe të promovojnë njohjen e historisë së tyre.

BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të sigurojë përafrimin e plotë të kuadrit të saj legjislativ me *acquis-në* e BE-së pas anëtarësimit për të garantuar gëzimin e plotë të **të drejtave të shtetësisë të BE-së**.

4. Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria

BE-ja vëren se Shqipëria e ka një kuadër ligjor dhe institucional për të **luftuar krimin e organizuar**, megjithëse në të duhet të miratohen disa ndryshime në mënyrë që ky kuadër të përafrohet plotësisht me *acquis-në* e BE-së që përfshin edhe legjislacionin në lidhje me kriminalizimin e pastrimit të parave, si dhe në lidhje me rikuperimin dhe konfiskimin e aseteve. BE-ja nënvizon se bashkëpunimi i Shqipërisë për zbatimin e ligjit me Shtetet Anëtare të BE-së, CEPOL, Europol dhe Eurojust, si dhe një përfshirje shumë aktive në EMPACT, po japin rezultate pozitive. BE-ja vëren se këto përpjekje duhet të forcohen më tej. BE-ja nënvizon gjithashtu se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të konsoliduar historikun e hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve të formës së prerë dhe sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve që lidhen me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar proaktiv dhe efikas. BE-ja vëren se Shqipëria duhet t'i pajisë institucionet që luftojnë kundër kimit të organizuar me burime të përshtatshme dhe të mjaftueshme. BE-ja vlerëson gjithashtu planin e Shqipërisë për t'u siguruar që procedimet penale të shoqërohen sistematikisht me

[Type here]

hetime financiare që nga fillimi dhe për ngritjen e kapaciteteve për trajtimin e hetimeve financiare komplekse. BE-ja thekson më tej angazhimin e Shqipërisë për rritjen e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve, për ngrirjen e aseteve që lidhen me aktivitetet kriminale dhe për nxitjen e ripërdorimit të tyre për qëllime sociale.

BE-ja vëren se Shqipëria është hequr nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) pas pezullimit të programit të planifikuar të amnistisë fiskale dhe pajtueshmërisë vullnetare të taksave. BE-ja vë në dukje rëndësinë e marrjes së masave nga Shqipëria në mënyrë që ndryshimet e ardhshme në legjislacionin penal, duke përfshirë edhe amnistitë apo programet e mundshme të pajtueshmërisë vullnetare tatimore, të jenë në përputhje me planet e vendit, të çojnë përpara luftën kundër krimit të organizuar dhe të jenë në përputhje me acquis-në përkatëse të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare, si ato të vendosura nga Moneyval dhe FATF.

BE-ja e inkurajon Shqipërinë të miratojë të gjithë legjislacionin e nevojshëm ligjor dhe nënligjor në fushën e **krimit kibernetik** dhe të aderojë në protokollin e dytë shtesë të Konventës së Budapestit për të luftuar efektivisht krimin kibernetik. BE-ja vëren se Shqipëria duhet të zhvillojë një historik solid në lidhje me parandalimin dhe goditjen e krimit kibernetik, veçanërisht nëpërmjet krijimit të një reagimi më efikas për zbatimin e ligjit, duke u fokusuar tek zbulimi, gjurmueshmëria dhe procedimi i kriminelëve kibernetikë.

BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të parashikuar si vepra penale të gjitha format e **abuzimit seksual të fëmijëve** dhe e inkurajon Shqipërinë t'i kushtojë vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe parandalimit (duke përfshirë edhe parandalimit të riviktimizimit) të abuzimit seksual të fëmijëve *online* dhe *offline*.

BE-ja vëren se në Shqipëri ka një numër të madh armësh zjarri dhe e inkurajon Shqipërinë të reduktojë posedimin dhe **trafikimin e paligjshëm të armëve të zjarrit**. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të përafrojë masat e saj me objektivat e Udhërrëfyesit Rajonal për të kontrolluar më mirë armët e vogla dhe të lehta (AVL) në Ballkanin Perëndimor. BE-ja vlerëson gjithashtu planin e Shqipërisë për të rritur përpjekjet për më shumë ndërjegjësim, komunikim dhe edukim mbi rreziqet dhe kërcënimet që lidhen me keqpërdorimin, mbajtjen pa leje dhe trafikimin e armëve të zjarrit/AVL-ve, si dhe për reduktimin e armëve të paligjshme të zjarrit nëpërmjet legalizimit, dorëzimit vullnetar dhe çaktivizimit.

BE-ja vëren se Shqipëria është një vend origjine, tranziti dhe destinacion për **trafikimin e qenieve njerëzore** dhe duhet të forcojë masat e ndërmarra kundër trafikimit duke u fokusuar tek ndikimi i konsiderueshëm tek gratë dhe vajzat. BE-ja nënvizon planin e Shqipërisë për të përmirësuar identifikimin e hershëm dhe mbrojtjen e viktimave nëpërmjet një qasjeje me në qendër viktimën, e cila duhet të integrohet më mirë dhe në mënyrë më të qëndrueshme në hetimet dhe procedimet penale. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të zhvillojë një historik solid hetimesh proaktive, procedimesh dhe dënimesh të formës së prerë në këtë fushë.

BE-ja vëren se autoritetet ligjzbatuese të Shqipërisë kanë një nivel të mirë **bashkëpunimi në fushën e drogës** me homologët e tyre në shtetet anëtare të BE-së. BE-ja e inkurajon Shqipërinë të miratojë një kuadër strategjik gjithëpërfshirës në fushën e drogës. BE-ja nënvizon se përtej miratimit të një kuadri formal, do të jetë vendimtare që Shqipëria të demonstrojë edhe një qasje strategjike gjithëpërfshirëse për të luftuar në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme kultivimin,

[Type here]

prodhimin dhe trafikimin e drogës. BE-ja vlerëson më tej planin e Shqipërisë për të forcuar dhe për ta bërë plotësisht funksional kuadrin e saj institucional, në veçanti duke krijuar një Observator Kombëtar të Drogave dhe një sistem kombëtar operacional të paralajmërimit të hershëm për shkëmbimin e informacionit rreth substancave të reja psikoaktive. BE-ja nënvizon nevojën e Shqipërisë për të zhvilluar një historik solid konfiskimesh dhe asgjësimesh të drogës, si dhe të konfiskimit të aseteve përkatëse.

BE-ja vëren se Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe institucional strategjik për të **luftuar terrorizmin**, i cili ka nevojë për disa ndryshime për t'u përafuar plotësisht me acquis-në e BE-së. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të siguruar burime të përshtatshme, për të përmirësuar bashkëpunimin ndërinstucional dhe atë ndërkombëtar, si dhe për të forcuar mekanizmat e menaxhimit të rasteve dhe referimit. BE-ja vlerëson përpjekjet e bëra për Parandalimin dhe Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), sidomos me konsolidimin e Qendrës CVE. Ndonëse përpjekjet e bëra janë për t'u përgëzuar, radikalizimi në burgje dhe shpërndarja *online* e përmbajtjeve terroriste duhet të vazhdojnë të shihen me vëmendje. BE-ja vëren se bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacioneve sensitive me Europolin dhe me Shtetet Anëtare është i kënaqshëm. BE-ja nënvizon se nevojitet punë e mëtejshme për të adresuar financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave veçanërisht përmes përmirësimit të efikasitetit të hetimeve të financimit të terrorizmit. BE-ja vëren gjithashtu se Shqipëria është në procesin e ndryshimeve në legjislacionin e saj që rregullon përdorimin e Regjistrave të Emrave të Pasagjerëve (PNR) për të rritur aftësinë e të luftuarit të terrorizmit dhe veprave të rënda penale që kanë lidhje me udhëtimet ajrore.

BE-ja vëren se Shqipëria angazhohet për **mbrojtjen e infrastrukturës kritike** nëpërmjet rishikimit të kuadrit ligjor për rezistencën e entiteteve kritike, përmirësimit të kapaciteteve për identifikimin e infrastrukturës kritike dhe hartimit të kritereve për menaxhimin e tyre, duke përfshirë edhe analizën e rrezikut. Shqipëria duhet të sigurojë vendosjen e sigurt të rrjeteve 5G së bashku me zbatimin gjithëpërfshirës të paketës së mjeteve të BE-së për sigurinë kibernetike 5G.

BE-ja vëren se Shqipëria i ka të sanksionuara në legjislacion parimet bazë të **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare**, por nevojitet që ato të përafrohen më tej me acquis-në e BE-së. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për ratifikimin e konventave ndërkombëtare përkatëse ende të paratifikuara në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, veçanërisht Konventën e Hagës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës (2005). BE-ja inkurajon gjithashtu Shqipërinë të rrisë kapacitetet e saj administrative për të përmbushur kërkesat e BE-së për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare.

BE-ja vëren se sa i përket **migracionit**, Shqipëria duhet të përditësojë Strategjinë e saj gjithëpërfshirëse Kombëtare për Migracionin dhe planin përkatës të veprimit dhe të vazhdojë zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor të paraqitur nga Komisioni në dhjetor 2022. BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet gjithashtu të vazhdojë me miratimin, zbatimin, testimin dhe financimin e duhur të planit të emergjencës në rast të mbërritjes së një numri të konsiderueshëm emigrantësh dhe azilkërkuesish. BE-ja vlerëson gjithashtu planin e Shqipërisë për të miratuar disa ndryshime të nevojshme në fushën e migracionit të ligjshëm për ta përafuar atë me disa dispozita për bashkimin familjar, lëshimin e lejes me një aplikim të vetëm, si dhe me ndryshimet e fundit në kartën blu të BE-së. BE-ja inkurajon Shqipërinë të

[Type here]

miratojë disa ndryshime në fushën e migracionit të parregullt, ndër të tjera, për ta përafuar atë me Direktivën e Sanksioneve të Punëdhënësit. BE-ja mirëpret rivendosjen e kompetencave hetimore brenda Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit. BE-ja vëren se personeli dhe kapaciteti i kësaj drejtorie duhet të rritet. BE-ja nënvizon se bashkëpunimi i Shqipërisë me Shtetet Anëtare dhe Frontex për operacionet e ripranimit dhe kthimit është shumë i mirë. BE-ja inkurajon Shqipërinë të sigurojë kapacitete të përshtatshme dhe të mjaftueshme pritëse dhe të zbatojë procedurat e kthimit në përputhje me ligjin për të huajt dhe në përputhje me acquis-në e BE-së.

BE-ja vlerëson bashkëpunimin me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin për forcimin e sistemit kombëtar të **azilit** dhe pritjes. BE-ja inkurajon Shqipërinë për një zbatim cilësor të ligjit të miratuar së fundi për azilin dhe për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme administrative shtesë, duke siguruar njëkohësisht edhe përafrimin e mëtejshëm me acquis-në. BE-ja inkurajon gjithashtu Shqipërinë të bëjë referime sistematike në procedurën e azilit. BE-ja vlerëson gjithashtu planin e Shqipërisë për trajtimin e azilkërkuesve përmes mbështetjes dhe shërbimeve të drejtpërdrejta të qeverisë. BE-ja vlerëson se çështja e paraqitjes prej shumë qytetarëve shqiptarë të kërkesave të pabazuara për azil në shtetet anëtare të BE-së kërkon ende përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

BE-ja vlerëson se **politika e vizave** e Shqipërisë nuk është ende plotësisht në përputhje me BE-në. BE-ja rikujton se heqja e përkohshme e kërkesave për viza nuk është në përputhje me acquis-në e BE-së. BE-ja vëren se Shqipëria ka hartuar një plan për harmonizimin e politikës së saj të vizave me BE-në dhe e inkurajon Shqipërinë ta zbatojë atë plan në kohën e duhur. BE-ja vë në dukje gjithashtu se sistemet e informacionit të Shqipërisë kanë nevojë për disa përshtatje teknike shtesë për të qenë në përputhje me Sistemin e Informacionit të Vizave (VIS).

BE-ja vlerëson bashkëpunimin e mirë dhe të vazhdueshëm operacional me Frontex-in për mbikëqyrjen e kufijve nëpërmjet Operacionit të Përbashkët të ngritur që në vitin 2019, në lidhje me **Shengenin dhe Kufijtë e Jashtëm**. BE-ja rikujton se një pjesë e acquis-së së Shengenit do të zbatohet në Shqipëri vetëm pas një vendimi të Këshillit për heqjen e kontrolleve mbi personat në kufijtë e brendshëm të marrë në bazë të një vlerësimi të Shengenit për gatishmërinë e Shqipërisë, duke marrë parasysh një raport të Komisionit ku konfirmohet se Shqipëria vazhdon të përmbushë angazhimet e ndërmarra në negociatat e anëtarësimit që janë relevante për acquis-në e Shengenit. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të adresuar lëvizjet e shumta të oficerëve në kufi.

Në lidhje me **falsifikimin e euros**, BE-ja vë vlerëson planin e Shqipërisë për të vazhduar me shkëmbime të mëtejshme informacioni me Komisionin Evropian, Europolin dhe Bankën Qendrore Evropiane, sipas marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit për mbrojtjen e monedhës euro nga falsifikimi.

5. Kriteret ekonomike

BE-ja vëren se Shqipëria është në rrugën e duhur për t'u bërë një **ekonomi tregu funksionale**. BE-ja vëren se Shqipëria po përparon në kapacitetin e saj për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian. BE-ja nënvizon konsensusin e vazhdueshëm dhe të gjerë së brendshmi mbi bazat e politikës ekonomike, duke përfshirë edhe mbi rolin e kufizuar të shtetit në ekonomi dhe angazhimin politik për liberalizimin e tregut. BE-ja vëren se

[Type here]

pavarësisht disa përparimeve në këtë drejtim gjatë viteve të fundit, siguria e dobët juridike, niveli i lartë i aktivitetit ekonomik informal, niveli i ulët i zhvillimit të sektorit financiar dhe vështirësitë në regjistrimin e titujve të pronësisë së tokës vazhdojnë të kufizojnë funksionimin efikas të ekonomisë së tregut, gjë që reflektohet në një progres dhe rritje të ngadaltë që është nën potencialin e saj. BE-ja inkurajon Shqipërinë që të adresojë në mënyrë sistematike dhe të plotë si rekomandimet e BE-së të përcaktuara në paketat e njëpasnjëshme të zgjerimit, ashtu edhe udhëzimet e miratuara bashkërisht në kontekstin e Konkluzioneve të Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe në kuadrin e angazhimeve të ardhshme si pjesë e Planit të Rritjes, të cilat duhet ta ndihmojnë Shqipërinë në përmbushjen e kriterëve ekonomike. Pavarësisht boshllëqeve të konsiderueshme që vazhdojnë të ekzistojnë krahasuar me nivelet rajonale dhe evropiane, BE-ja nënvizon se infrastruktura e energjisë dhe transportit në Shqipëri, dixhitalizimi i ekonomisë dhe rezultatet e arsimit janë përmirësuar shumë. BE-ja vëren gjithashtu se investimet në të gjitha fushat e infrastrukturës fizike duhet të vazhdojnë në nivele të larta, plotësuar me përmirësimin e menaxhimit të investimeve publike dhe reformave të qeverisjes. BE-ja inkurajon Shqipërinë të përmirësojë konkurrueshmërinë që pengohet aktualisht nga mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, nevojat e paplotësuara për investime në zhvillimin njerëzor dhe shpenzimet vazhdimisht të ulëta për Kërkim Shkencor dhe Zhvillim përmes arritjes së rezultateve më cilësore në arsim dhe stimujve për investime në kërkimin shkencor. BE-ja inkurajon gjithashtu Shqipërinë që ta bëjë më të gjerë e më të përshtatshme mbrojtjen sociale dhe sigurimin shëndetësor për të ulur përqindjen e popullsisë që rrezikon të jetë e varfër për të mundësuar kështu një zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës dhe të balancuar social.

6. Kapitulli 5 - Prokurimi publik

BE-ja vlerëson nivelin e lartë të harmonizimit të Shqipërisë me acquis-në e BE-së në fushën e **sektorëve klasikë dhe të shërbimeve**. BE-ja inkurajon Shqipërinë të rishikojë kufijtë për kontratat e furnizimit dhe shërbimeve për përafrimin e periudhave minimale të aplikuara në procedurat e prokurimit, si dhe të afateve për paraqitjen e ankesave, me Direktivat e BE-së për Prokurimin Publik. BE-ja vëren gjithashtu se në fushën e koncesioneve, Shqipëria është pjesërisht e përafruar me acquis-në e BE-së. BE-ja inkurajon Shqipërinë për një harmonizim të mëtejshëm për të adresuar ndër të tjera çështje si propozimet e pakërkuara, riskun operacional dhe objektin legjislativ. BE-ja nënvizon nivelin e lartë të harmonizimit të Shqipërisë me acquis-në e BE-së sa i përket **prokurimit në fushën e mbrojtjes**.

BE-ja vlerëson përgatitjen deri diku të Shqipërisë sa i përket **zbatimit dhe kapaciteteve të zbatimit të ligjit** për prokurimin publik. BE-ja nënvizon se sistemi i prokurimit publik duhet që në proceset e prokurimit, krahas efikasitetit, t'i mëshojë më shumë transparencës, integritetit dhe konkurrencës. BE-ja inkurajon Shqipërinë të forcojë mbështetjen për autoritetet kontraktore nëpërmjet Agjencisë së Prokurimit Publik për të përmirësuar më tej funksionimin e sistemit të prokurimit publik.

BE-ja nënvizon nivelin e lartë të harmonizimit të Shqipërisë me Direktivën për **Mjetet Juridike**. BE-ja vëren se zbatimi nga Shqipëria i sistemit gjithëpërfshirës të menaxhimit të apelimeve elektronike dhe ankesave elektronike për paraqitjen dhe menaxhimin elektronik të rasteve ka siguruar një nivel të lartë transparence dhe ka përmirësuar shqyrtimin në kohë të

[Type here]

ankesave. BE-ja inkurajon Shqipërinë të përmirësojë kapacitetin e Komisionit të Prokurimit Publik për shqyrtimin e një numri të madh ankesash.

7. Kapitulli 18 - Statistikat

BE-ja vëren se **infrastruktura statistikore** e Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me acquis-në e BE-së. BE-ja inkurajon Shqipërinë të caktojë burime të mjaftueshme për sektorin e statistikave në mënyrë që të arrihet harmonizimi i plotë me acquis-në e BE-së.

BE-ja vëren se Shqipëria ka zbatuar **klasifikimin kryesor të BE-së** me shkallë të ndryshme përputhshmërie me acquis-në. BE-ja inkurajon Shqipërinë të marrë masat për kryerjen e punës së mëtejshme që nevojitet për regjistrat statistikore për të siguruar përputhshmërinë e plotë me acquis-në e BE-së.

BE-ja nënvizon përafrimin e pjesshëm të Shqipërisë me acquis-në e BE-së sa u përket **statistikave sektoriale**. BE-ja inkurajon Shqipërinë të bëjë përparim të mëtejshëm në të gjitha fushat statistikore për të arritur harmonizimin e plotë.

8. Kapitulli 32 - Kontrolli financiar

BE-ja vëren se Shqipëria është pjesërisht e përafuar me acquis-në e BE-së sa i përket **kontrollit të brendshëm financiar publik** dhe se kuadri legjislativ i Shqipërisë përputhet gjerësisht me standardet e BE-së. BE-ja nënvizon se sistemi i kontrollit të brendshëm është vetëm pjesërisht efikas dhe se llogaridhënia në nivelet drejtuese mbetet e kufizuar në praktikë. BE-ja inkurajon Shqipërinë të përmirësojë zbatimin e kontrollit të brendshëm efikas dhe të përforcojë monitorimin nga Njësia Qendrore e Harmonizimit.

BE-ja inkurajon Shqipërinë të rrisë ndikimin e **funksioneve të auditimit** të brendshëm dhe të jashtëm që ato të jenë në përputhje të plotë me standardet dhe parimet profesionale të BE-së.

BE-ja inkurajon Shqipërinë të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj kombëtar me direktivën e BE-së për luftën kundër mashtrimit ndaj **interesave financiare të BE-së** me anë të legjislacionit penal.

BE-ja inkurajon Shqipërinë të vendosë zyrtarisht dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente kombëtare për **mbrojtjen e euros nga falsifikimi**.

Duke pasur parasysh nivelin aktual të përgatitjeve të Shqipërisë, BE-ja vlerëson se në pritje të arrijtes nga ana e Shqipërisë të progresit në përafrimin dhe zbatimin e acquis-së së BE-së dhe standardeve përkatëse evropiane që mbulon grupkapitulli 1 (*Cluster 1*), përpara se të ndërmerren hapat e ardhshëm në procesin e negociatave për këtë grup kapitujsh, do të duhet që Shqipëria të përmbushë këto standarde të ndërmjetme:

- në nivel horizontal për grupkapitullin 1, Shqipëria duhet të sigurojë një monitorim nga afër dhe të përhershëm të zbatimit në vazhdimësi të udhërrëfyesve për sundimin e ligjit, reformës së administratës publike dhe funksionimit të institucioneve demokratike nëpërmjet një mekanizmi të fortë dhe multidisiplinar, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve njerëzore dhe financiare, kapaciteteve institucionale, respektimit të afateve të përcaktuara dhe dialogut aktiv me shoqërinë civile.

[Type here]

Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Shqipëria vazhdon të zbatojë reformën e saj gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke sjellë përmirësime në paanshmërinë, pavarësinë, përgjegjshmërinë, profesionalizmin, cilësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard pasi të ketë arritur sa vijon:

- Një zbatim të mirë në vazhdimësi të reformës në drejtësi, që duhet të konsolidohet në përputhje me acquis-në përkatëse të BE-së dhe standardet evropiane, duke përfshirë forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve, efikasitetit dhe pavarësisë, duke përfshirë parimet e integritetit, meritës dhe transparencës, të organeve vetëqeverisëse të gjyqësorit, veçanërisht Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke përfshirë edhe emërimin e anëtarëve të tyre;
- Forcimin e pavarësisë dhe llogaridhënies nëpërmjet përmbylljes së rregullt të procesit të vetingut nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe ruajtjen e llogaridhënies dhe integritet në sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet edhe pas vetingut nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, si dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë me kapacitete tashmë të ngritura, duke përfshirë edhe përmes vlerësimeve të plota, verifikimit sistematik dhe efikas të deklaratave të pasurisë në përputhje me standardet e larta të vendosura nga vetingu, aplikimit konsistent të emërimeve dhe ngritjeve në detyrë mbi bazë merite dhe sigurimit të rezistencës sistematike të sistemit gjyqësor ndaj tentativave për ndikim të paligjshëm nga brenda dhe jashtë sistemit gjyqësor;
- Përmirësimin e cilësisë së gjyqësorit, duke përfshirë uljen e ndjeshme të çështjeve të prapambetura me arritjen e dy të tretave të parashikimeve të planifikimit vjetor bazuar në kritere objektive me elemente cilësore dhe sasiore, duke avancuar ndjeshëm publikimin në kohë të vendimeve të zbardhura, duke rritur cilësinë e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, forcimin e Shkollës së Magjistraturës, veçanërisht duke siguruar integritetin dhe cilësinë e personelit mësimdhënës, si dhe duke përmirësuar kapacitetet dhe provimet e pranimit;
- Rritjen graduale të efikasitetit dhe performancës së gjykatave dhe prokurorive dhe promovimin e shërbimeve cilësore të drejtësisë, duke përfshirë shkurtimin e kohës së gjykimit, uljen e numrit të çështjeve gjyqësore të prapambetura, plotësimin e rreth gjysmës së vendeve vakante në gjyqësor dhe rritjen e personelit mbështetës, duke bërë investimet e duhura në buxhetin e gjyqësorit për të plotësuar si duhet nevojat e gjyqësorit, duke përfshirë infrastrukturën, drejt mesatares së BE-së, promovimin e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve dhe krijimin e një sistemi mirëfunksional të menaxhimit të integruar të çështjeve.

Shqipëria duhet të bëjë përparim të mëtejshëm dhe të konsiderueshëm në goditjen dhe parandalimin e korrupsionit. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të nërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon:

- Rritjen e kapaciteteve operationale dhe konsolidimin e burimeve financiare dhe njerëzore të organeve të specializuara kundër korrupsionit dhe të institucioneve të zakonshme gjyqësore për të luftuar korrupsionin;

[Type here]

- Të ketë bërë përparim të prekshëm në të gjitha nivelet drejt një historiku solid hetimesh, procedimesh dhe dënimesh në çështjet e korrupsionit, veçanërisht dënime të formës së prerë të niveleve të larta, duke përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve;
- Forcimin e efikasitetit të kuadrit për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë arritjen e një progresi të konsiderueshëm në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s, sigurimin e verifikimit efikas të deklaratave të pasurisë dhe përmbylljen konsistente të hetimeve administrative me sanksionet përkatëse dhe referimin në prokurori;

Shqipëria duhet të forcojë më tej mbrojtjen e të drejtave themelore në praktikë. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të ndërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon:

- Miratimin dhe fillimin e zbatimit të reformës për mbrojtjen e të dhënave në përputhje me acquis-në e BE-së, duke përfshirë reagimin sistematik dhe marrjen e masave mbrojtëse efikase për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale;
- Forcimin e lirisë së shprehjes, duke përfshirë edhe lirinë e medias, ndër të tjera nëpërmjet një kuadri legjislativ dhe rregullator të reformuar në përputhje me standardet evropiane, praktikat më të mira dhe rekomandimet përkatëse dhe nëpërmjet masave konkrete për rritjen e sigurisë së gazetarëve;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale, duke përfshirë kapacitetet e organeve të barazisë, sigurimin e përafrimit legjislativ me acquis-në e BE-së për mosdiskriminimin, barazinë gjinore dhe luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, dhe ofrimin e mekanizmave efikasë për kompensimin dhe ndihmën ndaj viktimave siguruar në masën më të madhe nga buxheti i shtetit;
- Përforcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve udhëhequr nga interesi më i mirë i fëmijës, duke përfshirë edhe sa u përket fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, veçanërisht përmbylljen e tranzicionit drejt kujdesit me bazë komunitetin;
- Arritjen e një progresi vendimtar drejt krijimit të një sistemi efikas dhe transparent të regjistrimit dhe menaxhimit të integruar të pronës që ofron tituj të qartë dhe të sigurt pronësie dhe drejt një shërbimi plotësisht të dixhitalizuar në praktikë jo më vonë se afatet e parashikuara në angazhimet përkatëse të Shqipërisë ndërmarrë në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit. Të ketë arritur një përparim vendimtar drejt marrjes së masave që të gjitha të dhënat kadastrale, duke përfshirë edhe titujt e pronësisë dhe hartat kadastrale, të digjitalizohen dhe përditësohen me kujdes për të hequr sistematikisht të dhënat dhe ankesat e mbivendosura ose të pasakta, të trajtohen në mënyrë efikase, dhe drejt përfundimit të regjistrimit fillestar të pronave jo më vonë se afatet e parashikuara në angazhimet përkatëse të Shqipërisë ndërmarrë në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit. Të ketë ulur numrin e çështjeve të prapambetura gjyqësore sa i përket pronësisë dhe të ketë zbatuar me efikasitet vendimet e gjykatës;
- Miratimin e akteve nënligjore që lidhen me vetëidentifikimin e lirë dhe përdorimin e gjuhëve të personave që u përkasin pakicave siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit dhe në përputhje me standardet evropiane dhe ngritjen e kapaciteteve zbatuese, duke përfshirë edhe ato të Komisionit për Pakicat Kombëtare dhe burimet e tij;
- Përforcimin e përafrimit të kornizës së saj legjislative me acquis-në e BE-së për të drejtat e shtetësisë.

[Type here]

Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria

Shqipëria duhet të bëjë përparim të prekshëm në luftën kundër krimit të organizuar. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të ndërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon:

- Përafrimin e mëtejshëm me acquis-në e BE-së për luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë kriminalizimin e pastrimit të parave, si dhe rikuperimin dhe konfiskimin e aseteve;
- Të ketë bërë përparim të prekshëm drejt një historiku solid hetimesh, procedimesh dhe dënimesh të formës së prerë në të gjitha fushat e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar (duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe abuzimin seksual të fëmijëve, krimin kibernetik, trafikimin e armëve, trafikun e drogës), pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- Të ketë demonstruar një praktikë të besueshme dhe konsistente të nisjes së hetimeve financiare paralele në rastet kur ka të bëjë me krim të organizuar dhe pastrim parash.
- Të ketë arritur përparim të prekshëm drejt një historiku solid sekuestrimesh dhe konfiskimesh të formës së prerë të aseteve, me një zyrë plotësisht funksionale të rikuperimit të pasurive përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni vendas;
- Të ketë bërë përparim thelbësor në çmontimin e rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus te ndikimi i konsiderueshëm tek gratë dhe vajzat.

Shqipëria duhet të ketë rritur përpjekjet për bashkëpunimin në fushën e drogës. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të ndërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon:

- Të ketë ngritur një Sistem Kombëtar funksional të Paralajmërimit të Hershëm të pajisur me burime të mjaftueshme dhe një Observator Kombëtar të Drogave, dhe të ketë përafruar legjislacionin e saj me acquis-në e BE-së për drogat dhe prekursorët e drogës;
- Të ketë bërë përparim të prekshëm drejt një historiku solid sekuestrimi të drogës, asgjësimit dhe konfiskimit të aseteve përkatëse, duke siguruar në të njëjtën kohë dënimin e shkeljeve të ligjit për kultivimin e ligjshëm të kanabisit.

Shqipëria duhet të arrijë rezultate konkrete thelbësore në fushën e migracionit të ligjshëm, migracionit të parregullt dhe azilit, si dhe në çështjet që lidhen me acquis-në e Shengenit dhe kufijtë e jashtëm, në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard të ndërmjetëm pasi të ketë arritur sa vijon:

- Të ketë siguruar kapacitete të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për menaxhimin e kufijve dhe personel të mjaftueshëm për menaxhimin e flukseve të përziera të migracionit, duke përfshirë kapacitete të mjaftueshme pritëse, mjete efikase për kryerjen e kthimeve, plane për menaxhimin e numrit më të madh të mbërritjeve, në përputhje me strategjitë ekzistuese të migracionit në fuqi, si dhe një harmonizim më të madh të politikës së vizave në bazë të një plani konkret;
- Të ketë bërë përparim të konsiderueshëm në luftën kundër kontrabandimit të migrantëve;

[Type here]

- Të ketë marrë masat për të pasur një procedurë funksionale për azilin sipas acquis-së së BE-së dhe standardeve evropiane, ku shteti të ofrojë shërbimet e nevojshme për azilkërkuessit.

* *

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të përgatitjeve të Shqipërisë dhe në varësi të përmbushjes nga Shqipëria të standardeve të ndërmjetme në lidhje me kapitujt për sundimin e ligjit, BE-ja vëren se duke qenë se Shqipëria duhet të vazhdojë të arrijë përparim në përafrimin dhe zbatimin e acquis-së së BE-së që mbulojnë kapitujt në vijim dhe pa paragjykim për çfarëdolloj kushti shtesë që mund të vendoset sa u përket standardeve të mëtejshme përcaktuar në grupkapitullin 1, këta kapituj mund të mbyllen vetëm përkohësisht sapo BE-ja të bjerë dakord se janë përmbushur këto standarde:

Kapitulli 5 - Prokurimi publik

- Shqipëria duhet të përafrojë plotësisht kuadrin ligjor kombëtar me acquis-në e BE-së në lidhje me të gjitha fushat e prokurimeve publike, duke përfshirë legjislacionin e saj për koncesionet dhe partneritetet publik-privat dhe marrëveshjet ndërkombëtare që përjashtojnë prokurime të caktuara nga rregullat e prokurimit publik, në përputhje me Traktatin e KE-së, legjislacionin e BE-së për prokurimin dhe dispozita të tjera përkatëse të acquis-së së BE-së;
- Shqipëria duhet të ngrejë kapacitetet e duhura administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet dhe të marrë masat e duhura për të siguruar zbatimin e duhur të legjislacionit vendas në këtë fushë në kohën e duhur përpara anëtarësimit;
- Shqipëria duhet të demonstrojë një historik solid të një sistemi prokurimi publik të drejtë dhe transparent që ofron leverdisshmëri, konkurrencë dhe garanci të forta kundër korrupsionit.

Kapitulli - 18 Statistikat

- Shqipëria duhet të paraqesë të dhëna makroekonomike kyçe (llogaritë kombëtare dhe GFS/EDP) në përputhje me metodologjinë e Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA) 2010, si dhe me programin e transmetimit ESA 2010, kërkesat e njoftimit të EDP-së dhe kërkesat e tjera përkatëse së bashku me përshkrimin e detajuar të kërkuar të metodologjisë së përdorur dhe se Eurostat do të ketë verifikuar tashmë të dhënat dhe përshkrimet e paraqitura dhe do të ketë konfirmuar përputhshmërinë e duhur me rregullat e BE-së për sa i përket afatit kohor, plotësisë, koherencës, transparencës dhe saktësisë;
- Shqipëria duhet të miratojë një udhërrëfyes për: (i) mbylljen e çdo boshllëku të mbetur në të gjitha tabelat ESA 2010, (ii) transmetimin e çdo tabele të mbetur nga Programi i Transmetimit ESA 2010, (iii), mbylljen e çdo boshllëku të mbetur në informacion që duhet të dërgohet bashkë me Tabelat EDP, dhe (iv) zbatimin e çdo çështjeje metodologjike të mbetur. Eurostat konfirmon rëndësinë e udhërrëfyesit.

Kapitulli 32 - Kontrolli financiar

[Type here]

- Shqipëria duhet të ketë kapacitetet e duhura administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet dhe të marrë masat e duhura për të siguruar zbatimin si duhet të legjislacionit kombëtar të kontrollit të brendshëm financiar publik;
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) i Shqipërisë duhet të jetë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Lartë të Auditimit (INTOSAI);
- Shqipëria duhet të garantojë një bazë ligjore gjithëpërfshirëse për të ruajtur konfidencialitetin e hetimit të OLAF dhe kapacitetin e mjaftueshëm operacional për shërbimin e saj kombëtar të koordinimit kundër mashtrimit. Shqipëria zbaton një strategji kombëtare efikase kundër mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Shqipëria duhet të zbatojë një koordinim efektiv të aktiviteteve kundër mashtrimit dhe të shënojë një historik solid në bashkëpunim me Komisionin, OLAF-in dhe Zyrën e Prokurorit Publik Evropian (EPPO), për parregullsitë e raportuara dhe rastet e hetimit që përfshijnë fondet e BE-së, në mënyrë që ata të mund të kryejnë plotësisht detyrën e tyre;
- Shqipëria duhet të zbatojë Konventën Ndërkombëtare të Gjenevës të vitit 1929 për shtypjen e monedhave të falsifikuara, të përafrojë legjislacionin e saj me acquis-në e BE-së për vërtetimin e monedhave euro dhe trajtimin e monedhave euro të papërshtatshme për qarkullim dhe për vërtetimin e kartëmonedhave euro.

* *

Monitorimi i progresit në përafrimin dhe zbatimin e acquis-së së BE-së dhe standardeve përkatëse evropiane do të vazhdojë gjatë gjithë negociatave. BE-ja nënvizon se do t'i kushtojë vëmendje të veçantë monitorimit të të gjitha çështjeve specifike të përmendura më sipër, me synim sigurimin e kapacitetit administrativ të Shqipërisë, kapacitetit të saj për të përfunduar harmonizimin ligjor në të gjithë sektorët në këtë grup kapitujsh, si dhe përparimin e mëtejshëm në zbatimin e kuadrit të saj ligjor. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet lidhjeve ndërmjet këtij grupkapitulli dhe grupkapitujve të tjerë të negociimit. Një vlerësim përfundimtar i përputhshmërisë së legjislacionit të Shqipërisë me acquis-në e BE-së dhe standardeve përkatëse evropiane, si dhe i kapacitetit të saj zbatues mund të bëhet vetëm në një fazë të mëvonshme të negociatave. Përveç të gjithë informacionit që BE-ja mund të kërkojë për negociatat në këtë grup kapitujsh dhe që do t'i jepet Konferencës, BE-ja inkurajon Shqipërinë t'i japë rregullisht informacion të detajuar me shkrim Këshillit të Stabilizim Asociimit mbi progresin në zbatimin e acquis-së së BE-së.

Duke pasur parasysh të gjitha konsideratat e mësipërme, Konferenca do të duhet t'i rikthehet këtij grupkapitulli në një moment të përshtatshëm.

Përveç kësaj, BE-ja rikujton se nga 2 tetori deri në mbyllje të negociatave mund të ketë edhe acquis të re të BE-së.